

**KLSH merr pjesë në ditën e diskutimit publik në Shkodër, me temë:  
“Pjesëmarrja qytetare dhe bashkëpunimi me institucionet në luftën kundër korrupsionit”**

Në datën 13 shkurt 2024, u organizua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në Shkodër dita e diskutimit publik me temë: “Pjesëmarrja qytetare dhe bashkëpunimi me institucionet në luftën kundër korrupsionit”, në kuadër të nismës të projektit “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, mbështetur financiarisht me fonde të qeverisë suedeze.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të disa institucioneve, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e Drejtësisë dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të mediave, studentë, qytetarë etj.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë takim nga z. Koço Sokoli, me detyrë Kryeauditues pranë Departamentit Juridik.



Në këtë takim, përfaqësuesi i KLSH-së, z. Koço Sokoli, theksoi angazhimin e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në luftën kundër korrupsionit.

Angazhimi i institucioneve shtetërore të auditimit në luftën kundër korrupsionit kanë përparësi përse i përket efektivitetit të tyre në luftën kundër korrupsionit, kjo për shkak të aftësisë dhe mundësisë së zbulimit të rasteve të korrupsionit dhe parregullsive, evidentimit të pikave të dobëta të sistemit nëpërmjet të cilave korrupsioni arrin të depërtojë dhe zhvillohet. Për rrjedhojë, ato tashmë përfshihen si partnerë të rëndësishëm në çdo strategji kundër korrupsionit.

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), pjesë e së cilës është edhe KLSH, prej kohësh është angazhuar në promovimin e një roli aktiv të SAI-eve në luftën kundër korrupsionit. Në reflektim të përjasjeve të INTOSAI-it, por edhe SAI-eve të tjera homologe në luftën kundër korrupsionit, KLSH e ka reflektuar çështjen e korrupsionit dhe luftës ndaj këtij fenomeni jo vetëm në veprimtarinë audituese, por edhe në Planin Strategjik të institucionit.

Në zbatim të kësaj strategjie, KLSH është angazhuar seriozisht dhe maksimalisht në të qenit aktiv dhe produktiv në luftën kundër korrupsionit, duke përkrahur, mbështetur dhe u angazhuar në çdo iniciativë ndërinstitucionale brenda dhe jashtë vendit.

Bashkëpunimi i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit në ndjekje të një filozofie gjithëpërfshirëse ka ndërmarrë nismën e nënshkrimit të një sërë marrëveshjeve specifike bashkëpunimi, si ajo me SPAK, Prokurorinë e Përgjithshme, ILDKPI dhe disa organizata të shoqërisë civile etj.



Pjesëmarrësit në takim u njohën për kontributin e dhënë nga KLSH për hartimin e “Udhëzuesit praktik për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet SAI-ve dhe Agjencive Kundër Korrupsionit”, në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, miratuar në Kongresin XXIV Ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit (INCOSAI), nëntor 2022.

Z. Sokoli, referoi gjithashtu mbi kontributin e rëndësishëm që KLSH jep në luftën kundër korrupsionit edhe me pjesëmarrjen në grupin e punës të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) për vitet 2023-2030.